



27 Nëntor 2008

Shqyrtimi i Tarifës Nxitëse Feed-in për Energjinë Elektrike të Prodhuar nga Era RAPORT KONSULTATIV

DEKLARATË

Ky raport konsultativ është përgatitur nga ZRRE në mënyrë që të pranojë komente dhe mendime nga palët e interesuara. Ky dokument nuk duhet të konsiderohet se paraqet një vendim të ZRRE-së.

Përmbajtja e dokumentit:

Hyrje	3
Përmbushja e Caqeve Indikative.....	4
Tarifa Nxitëse Feed-in dhe metodologjitë e aplikuara nga shtetet e ndryshme	5
Tarifa Nxitëse Feed-in e propozuar nga ZRrE për energjinë e prodhuar nga era.....	6

Hyrje

Ky raport konsultativ është përgatitur nga ZRrE me qëllim të përcaktimit të Feed-in tarifës së energjisë së prodhuar nga era. Dispozitat ligjore në fuqi kërkojnë përmbushjen e caqeve indikative, përmbushjen e kërkesave për energji nga burimet e ripërtërishme dhe prodhimin e energjisë së pastër për të përmbushur obligimet nga direktiva 2001/77/EC e që është kërkesë edhe e Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

ZRRE në bashkëpunim me MEM-in dhe subjektet tjera që mbështesin promovimin e burimeve të ripërtërishme do të përgatisin bazën ligjore dhe rregullative për të nxitur investitorët privat për të investuar në burimet e ripërtërishme dhe hapjen e tregut.

Mandati i ZRrE-së për përcaktimin e tarifës nxitëse feed-in për burimet e ripërtërishme bazohet në:

- Autoritetin e dhënë nga “Ligji për Rregullatorin e Energjisë” 2004/9 - Nenet – 15.4 (a) dhe 46.2 (i amendamentuar me ligjin Nr. 03/L-080);
- Nga dispozitat e “Ligjit për Energjinë” 2004/8
- Në përputhje me Udhëzimin Administrativ Nr. 06/2007 “Mbi Caqet Indikative për Konsumin e Energjisë Elektrike dhe Ngrohjes nga Burimet e Ripërtërishme dhe Bashkëprodhimi”, dhe
- Neni 5 i Vendimit të Qeverisë së Kosovës mbi “Masat nxitëse për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e ripërtërishme dhe burimet e energjisë elektrike nga bashkëprodhimi në Kosovë për periudhën 2007-2013”
- Përmbushjes së obligimeve ndaj direktivës 2001/77/EC të Traktatit të Komunitetit të Energjisë

Propozimet nga ZRRE janë preliminare dhe ky raport konsultativ është publikuar si një mundësi për palët e interesuara që të paraqesin komentet e tyre, para se ZRRE të marrë vendim mbi tarifën e aprovuar. Tarifën e propozuar janë të përkohshme dhe tentative, dhe mund t’i nënshtrohen shqyrtimeve të mëtejshme.

Afati i fundit për pranimin e komenteve mbi këtë Raport konsultativ është 15 ditë nga data e publikimit në ueb faqen elektronike të ZRRE-së dhe të gjitha palët e interesuara kanë të drejtë t’i paraqesin komentet.

Komentet duhet të paraqiten me shkrim. Preferohet formati elektronik. Komentet e paraqitura me email duhet të dërgohen në adresën ero.pricing-tariffs@ero-ks.org me

paragrafin e theksuar në lëndë/subjekt “Tarifat Nxitëse Feed-in - Raporti Konsultativ – Komentet”.

Komentet e shtypura (hard-copy) duhet t’i dërgohen ZRRE-së në zyrën që gjendet në rr. Hamdi Mramori , Nr 1, 10000 Prishtinë të adresuara për “Departamentin e Çmimeve dhe Tarifave”.

Masat dhe politikat e shteteve në regjion dhe shteteve të BE-së në lidhje me promovimin dhe mbështetjen e burimeve të ripërtritshme janë: tarifat nxitëse feed-in, çertifikatat e prodhimit, kuotat për energjinë e ripërtritshme, tatimi në emetimet e karbonit (CO₂), tregtimi i emetimeve të gazrave, grantet e kapitalit dhe stimulimet tatimore. Dy mekanizmat në të cilët zakonisht mbështeten vendet e BE-së janë tarifat nxitëse feed-in dhe sistemi i kuotave. Feed-in tarifat i garantojnë prodhuesve një çmim të fiksuar për secilën njësi të energjisë të prodhuar nga burimet e ripërtritshme për një numër të caktuar të viteve, kjo natyrisht ka implikime buxhetore për konsumatorin final.

Sistemi i kuotave është i bazuar në përzgjedhjen dhe zbatimin e një sasive minimale të energjisë elektrike të prodhuar nga BR si kërkesë ligjore. Në BE, tarifat nxitëse feed-in konsiderohen më të suksesshme sesa sistemet e kuotave andaj edhe Kosova do të praktikojë një qasje të tillë.

Në mungesë të studimeve dhe vlerësimeve të fizibilitetit të BR nga potencialet e erës, ZRRE ka zgjedhur sistemin e krahasimit (“benchmark”) për të përcaktuar tarifat e energjisë së prodhuar nga era, ku si referencë janë marrë disa vende nga regjioni dhe BE.

Përmbushja e Cazeve Indikative

Sasia e konsumit nga Energjia e Ripërtritshme deri në vitin 2016 përcaktohet në dokumentin “Udhëzimi Administrativ Nr.06/2007 mbi Caset Indikative për Konsumimin e Energjisë Elektrike dhe Ngrohjes nga Burimet e Ripërtritshme dhe Koogjenerimi” lëshuar nga Ministria e Energjisë dhe Minierave. Këto caqe indikative mund të shihen në tabelën 1:

Nr.	Burimi i Energjisë	Caqet indikative për konsum të energjisë së prodhuar nga burimet e ripërtërishme (GWh)									
		2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
1	Hidro	125.84	134.56	145.03	156.31	167.01	178.40	190.50	203.18	216.67	230.39
2	Erë	0.00	0.00	0.00	32.56	68.73	108.51	151.89	199.80	252.14	309.94
3	Solare	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
4	Biomasë	0.00	0.00	0.00	0.00	11.63	17.45	19.77	23.26	29.08	29.08
TOTAL		125.84	134.56	145.03	188.87	247.37	304.36	362.16	426.24	497.88	569.40

Tabela 1

Sipas dokumentit në fjalë, duke filluar nga viti 2010 parashihet 32.56 e GWh/vit konsum i energjisë elektrike të prodhuar nga era, konsum ky që arrin 309.94 GWh në vitin 2016.

Tarifa Nxitëse Feed-in dhe metodologjitë e aplikuara nga shtetet e ndryshme

Në tabelën e mëposhtme shihen tarifat përfundimtare nga energjia e erës në disa shtete që kanë bërë mjaft progres në prodhimin e energjisë nga burimet e ripërtrishme, ekskluzivisht prodhimin e energjisë nga era. Metodologjitë më të aplikuara janë:

- Ndarja e tarifës sipas teknologjisë
- Ndarja e tarifës sipas kapacitetit të instaluar
- Tarifa fikse për të gjithë gjeneratorët e energjisë nga era
- Ndarja e tarifës sipas Energjisë së prodhuar

Shteti	Kushti	Tarifa
Bullgaria	Energjia elektrike e prodhuar nga elektrocentralet me ere. Kapaciteti deri ne 10MW	61.68 €/MWh
	Energjia elektrike e prodhuar nga elektrocentralet me erë, teknologjia e re e prodhuar pas 2006:	
	a) Gjeneratorët me erë deri në 2550 orë efektive pune ne vit	89.95 €/MWh
	b) Gjeneratorët me erë mbi 2550 orë efektive pune në vit	80.19 €/MWh
Lituania	Tarifë fikse	64 €/MWh
Maqedonia	Tarifë fikse	89 €/MWh
Sllovenia	Tarifë fikse - Kapaciteti i instaluar deri në 1MW	90 €/MWh
	Tarifë fikse - Kapaciteti i instaluar mbi 1MW	87 €/MWh
Franca	Faktori i Kapacitetit 23% (garancion për 5 vitet e para)	84 €/MWh
	Pas 5 viteve të para, nëse faktori i kapacitetit arrin 30%	60 €/MWh
	Pas 5 viteve të para, nëse faktori i kapacitetit arrin 41%	30€/MWh
Gjermania	60% e prodhimit të parashikuar	80.20 €/MWh
	100% e prodhimit të parashikuar, pas 15 vitesh	50.70 €/MWh
	150% e prodhimit të parashikuar, pas 5 vitesh	50.70 €/MWh
Kroacia	Tarifë fikse	90 €/MWh

Tarifa fikse është e aplikuar në Maqedoni, Lituani dhe Kroaci. Fillimisht ka qenë metodë e aplikuar edhe në Gjermani si një përqindje e caktuar e tarifës me pakicë. Kjo është metodologji e thjeshtë dhe e lehtë për t'u aplikuar, mirëpo në Francë ka shkaktuar problemin “wind-rush” që do të thotë se investimet e para bëhen në vendet më të “pasura” me erë. Rezultati është se vendet më të mira pajisen me teknologjinë më të vjetër, duke rezultuar në “wind ghettos”. E fundmja shpeshherë rezulton në efektin “NIMBY” (Not In My Back Yard). Mirëpo, efekti “wind rush” mund të jetë më pak evident në vendet më të vogla si Kroacia, Maqedonia dhe Kosova ngase hapësira gjeografike nuk mundëson diversifikim të madh të burimeve të erës, siç mund të jetë rasti në Gjermani apo në Francë. Prandaj, metoda më adekuate për t'u aplikuar në Kosovë është ajo e tarifës fikse, siç kanë bërë edhe shtetet fqinje.

Tarifa Nxitëse Feed-in e propozuar nga ZRrE për energjinë e prodhuar nga era

Feed-in tarifa për energjinë elektrike nga era të prodhuar nga teknologjia e re, është kalkuluar nga mesatarja e shteteve fqinje të cilat implementojnë metodën fikse duke përfshirë Kroacinë, Maqedoninë, Slloveninë dhe Lituani.

Tarifa që rezulton është paraqitur në tabelën që vijon, dhe vlen për të gjithë gjeneratorët e teknologjisë së re.

<i>Tarifat nxitëse Feed-in</i>	<i>Çmimi (euro/MWh)</i>
Të gjithë gjeneratorët me teknologji të re	84.00